



Pranuar - Primitjemo Më/Dana 08.07.2024 v.l.pod.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shticë Prilog	Vlera Vendos
	02-112/01		945



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosova
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Viti



Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 08/L-197 neni 5, paragrafi 1.2, nenit 80, 81; Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8, paragrafi, 1 dhe 2; Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032; Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ MASHTI nr.01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë shpall:

**KONKURS PUBLIK
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**

Nr.	Institucioni shkollor	Pozita	Vendi i lirë-kohëzgjatja	Numri i pozitave	
1	Sh.f.m.u. " Dëshmorët e Vitisë", Viti	Mësimdhënës/e për lëndën Art muzikor	Zëvendësim, pushim lehonisë	1	
2	Sh.f.m.u. " Bafti Haxhiu", Viti	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë angleze	Zëvendësim, pushim lehonisë	1	
3	Sh.f.m.u. "Njazi Rexhepi", Sllatinë	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë gjermane	Zëvendësim, pushim lehonisë	1	
4	Sh.f.m.u. "28 Nëntori", Vërban	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë gjermane	Vend i lirë	1	
5	Sh.f.m.u. "Nazmi Pajaziti", Radivojc	Mësimdhënës/e për lëndën Art muzikor	Vend i lirë	1	
6	Sh.f.m.u. " Dëshmorët e Lubishtë", Lubisht	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë shqipe Mësimdhënës/e për lëndën Matematikë	Vend i lirë Zëvendësim, pushim lehonisë	1 1	
7	Sh.f.m.u. " Halil Alidema"-Pozharan	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë shqipe	Vend i lirë	1	

8	Sh.f.m.u. "Ahmet Hajdari", Beguncë	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë shqipe	Vend i lirë	1	
		Mësimdhënës/e për lëndën Gjeografi-Ed. Qytetare	Vend i lirë	1	
		Mësimdhënës/e për lëndën Fizikë	Zëvendësim, pushim lehonisë	1	
9	Sh.f.m.u. "Dom Milel Tarabulluzi", Stubëll	Mësimdhënës/e për lëndën Histori	Vend i lirë	1	
		Mësimdhënës/e për lëndën Biologji	Zëvendësim, pushim lehonisë	1	
10	Sh.f.m.u. "Kenan Halimi"-Gjylekar	Mësimdhënës/e klasor	Zëvendësim, pushim lehonisë	1	
		Mësimdhënës/e për lëndën Matematikë	Zëvendësim, pushim lehonisë	1	

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë:

- Të jetë shtetasi Republikës së Kosovës;
- të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

• Kushtet dhe kualifikimi i konkurentëve

Të gjithë konkurentët duhet të kenë kualifikimin përkatës, sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ MASHTI nr.01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të nivelit master arsimor, sistemi katërvjeçar dhe baçelor 4 vjeçar, mund të pranohen niveli baçelor 3 vjeçar për një vit shkollor.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit, i cili merret në Zyrën e Arkivit të Komunës së Vitisë (Objekti i ri);
- Diplomat e të gjitha niveleve të kulifikimeve (certifikatat e diplomimit jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj të vërtetuara te noteri;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;

- Vërtetimin e përvojës së punës (nëse posedon);
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime ;
- Të diplomuarit jashtë vendit, diplomat e tyre t'i nënshtrohen procesit të nostrifikimit nga MASHTI-i. (Vendim mbi nostrifikim/njohje nga MASHTI-i)
- Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim)

Detyrat e mësimdhënësit

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera nënligjore;
- Të zbatojë detyrat e punës, duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin edukativo-arsimor;
- Të planifikoj, të udhëheq dhe të vëzhgojë nxënien dhe sjelljet e secilit nxënës;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurikulare;
- Të krijoj një atmosferë pune dhe disipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit të nxënësve;
- Të kontrolloj me rregull dhe të mbaj evidencë për suksesin dhe programin individual të secilit nxënës, si dhe të jetë në gjendje t'i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejtë për progresin e arritur të nxënësit sipas kërkesës;
- Të kujdeset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit;
- Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e nxënësit, duke realizuar takime individuale me prindër, kujdestar të fëmijës;
- Të ndihmoj kolegët në ngritjen e cilësisë së punës;
- Të marr pjesë në punën e organeve të shkollës;
- Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës;
- Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit organ i raporton dhe t'i kryej detyrat që mund t'i caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Të mos kërkojë apo pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër, përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së ose personave të caktuar nga ata;
- Të mos shfrytëzoj pozitën e punës për interesa private në dobi të një pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo rrethin shoqëror;
- Të ushtroj maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës, përfshirë ruajtjen e informatave, nëse nuk janë publike, të cilat lidhen me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik apo juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kontratës apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton;
- Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore;
- I punësuar është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe me aktet e tjera nënligjore;

- I punësuar sipas kontratës nuk do të kryej punë apo detyrë tjetër me orar të plotë nëse puna e tillë bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit e saj.

Dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmura-bashkangjitura në dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në formular t aplikimit).

Kandidatët e interesuar për aplikim, aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Arkivin e Komunës së Vitisë, bjehti tek Komuna e re.

Afati dhe mënyra e aplikimit: Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga data e publikimit të tij, (08.07.2024 deri më 07.08.2024).

Aplikacionet dorëzohen nga data **08.07.2024 - 07.08.2024**.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në zyrën e Arkivës të Komunës së Vitisë, kati përdhësë në ndërtesën e Administratës së Komunës së Vitisë dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Arkivës apo të dërgohet me postë në këtë adresë: Komuna e Vitisë, Rr. Hasan Kabashi, pa nr. Viti. Rezultatet shpallen web faqen <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkurseynjofitimet/konkurset/> dhe në veb faqen <https://konkursi.rks-gov.net/>

Kandidatët aplikantë të cilët kanë konkurruar, i njoftojmë se pas mbylljes së konkursit do t'i nënshtrohen vlerësimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Më datë 08.07.2024

Udhëheqësi i NjMBNj
Hysen Ymeri

